


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT EUGLENT OSMANAJ



Tiranë, më 05.12.2022

Nr. 701/3 Dosje

URDHËR

(PËR VENIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

Drejtuar : QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT-TIRANE.

Per dijeni:

Debitorit: Shoqeria "BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD" Dege e shoqërisë së huaj

Adresa: Lagjja "Sheq i Madh", Rruga "Leonardo Murialdo", Godina nr.37, Fier.

Kreditorit: Autoriteti i Konkurrences

Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Nr. 4, Kati IV, Tiranë

Unë, Euglent OSMANAJ , me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat , në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr.2324, të lëshuar me Datë 14.11.2022 prej Gjykates Administrative te Shkalles se Pare, Tirane kam vënë në ekzekutim këtë *Urdhër*, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 701, Datë 21.11.2022 kërkesën e kreditorit "*Autoriteti i Konkurences*" ndaj debitorit *Shoqeria "BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD" Dege e shoqërisë së huaj*, në lidhje me titullin ekzekutiv "Vendimit te Komisionit te Konkurences Nr.918, date 26.10.2022 te Autoritetit te Konkurences".

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Lajmërimin Nr.701 Dosje, Datë 21.11.2022 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Nr.2324, date 14.11.2022 në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

Adresa:Blv:Gjergj Fishta, Nd.3, Hyrja 6, Ap.8 , Njesia 10 , Tirane.

Email:euglentosmanaj@yahoo.com

Cel:069 74 90 508

KONSTATOVA Se :

Debitori Shoqeria "BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD" Dege e shoqërisë së huaj ka marrë njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi për të shlyer teresisht detyrimin.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit Shoqeria "BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD" Dege e shoqërisë së huaj me NIPT: K43128401L, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Në këto kushte, referuar nenit 519, 527 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe të Ligjit Nr. 26, datë 08.05.2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ

1. Venien e mases se sekuestros konservative mbi aktivet e debitorit Shoqeria "BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD" Dege e shoqërisë së huaj me NIPT: K43128401L, deri ne nje urdher te dyte te permbaruesit gjyqesor.
2. Për informimin, bllokimin dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorin e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.
3. Personat që bëhen pengesë, apo të cilët i paraprijnë ndonjë ndryshim të mundshëm në emër të debitorëve të përmendur në pikën 1, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas dispozitave sanksionuese që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pengimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo të titujve ekzekutive.
4. Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijeni.

PËRMBARUES GJYQËSOR

Euglent OSMANAJ



Adresa: Blv: Gjergj Fishta, Nd.3, Hyrja 6, Ap.8, Njesia 10, Tirane.

Email: euglentosmanaj@yahoo.com

Cel: 069 74 90 508